



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:107275
Datë: 07.09.2022
Numri i dokumentit: 03399501

P.nr.352/22
CPK.nr. 101/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoreshen profesionale Vlora Selmani-Rahimi, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh..... A.... të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat, Rr.“.....”, H....., ndaj debitorit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 06.05.2022, jashtë seancës më datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET – Debitori Komuna e Gjilanit,, që në afat prej 7 ditëve pas pranimit të këtij urdhëri, kreditorit Shukrije Akzemi, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën në vlerë prej 124.00€, në bazë të vendimit përmbartimor.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat me urdhrin e tij P.nr.352 /16 me datë 22.04.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndaj debitorit, në vlerë prej 124.00€, në bazë të Aktvendimit C.nr.2324/2020 i datës 30.12.2021 i plotfuqishëm me datë 18.01.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2022.

Debitori, pas pranimit të urdhrin për përmbartim në afat ligjor më dt.06.05.022 ka ushtruar prapësim, duke e theksuar se propozimit për përmbartim i mungon baza ligjore nga fakti se për zbatimin e vendimeve të kësaj natyre është kompetente gjykata e jo përmbartuesi privat, ngase kemi të bëjmë me kontest nga marrëdhënia e punës, nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet si i pabazuar.

Kreditori, ka ushtruar përgjegje në prapësim me datë 12.05.2022, duke theksuar se nuk qëndrojnë arsyet e cekura nga ana e debitorit, pasi që Aktvendimi C.nr.2324/2020 i datës 30.12.2021, është i plotfuqishëm me datë 18.01.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2022 dhe është i gatshëm për përmbartim, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës konstatoj se prapësimi i debitorit, është i pabazuar për arsye se i njëjti nuk ka vërtetuar asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, lidhur me bazueshmërinë e prapësimit, pasi që dokumenti përmbartimor më të cilën është lejuar përmbartimi është titull ekzekutiv, si dokument i besueshëm duke u bazuar në nenin 22.1.1 të LPP-së.

Po ashtu gjykata lidhur me pretendimin e debitorit se dokumenti nuk mund të përmbrohet sipas propozimit të përmbroesit privat por vetëm nga gjykata, gjykata një pretendim të tillë e refuzoj si të pabazuar ngase neni 22.1 i Ligjit të Procedurës përmbroimore përcakton se “ *Dokumente përmbroese janë: vendimi përmbroes i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbroese;*, andaj në rastin konkret Aktvendimi C.nr.2324/2020 i datës 30.12.2021, është i plotfuqishëm me datë 18.01.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2022 dhe është i gatshëm për përmbroim.

Nga të cekurat e mësipërme e në pajtim me nenin 5,71 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin I dhe II të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
CPK.nr.101/22, datë 05.09.2022

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan.